



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr. 11 / 2008;
më 23.05.2008, në ora 12:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Múfera Şinik;

Munguan: Et'hem Çeku, Slobodan Petroviq, Zef Morina, Haki Shatri (me arsye), Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari;

Përcjellës prezent: Adem Grabovci zv. ministër i MTT, Fehmi Stublla (zyrtar ligjor në ZKM), Blerina Uka nga NDI dhe Valmir Ismajli nga KDI;

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trases zonë me interes të veçantë publikë të Kosovës për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdar dhe Prishtinë-Hani i Elezit;
4. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trases zonë me interes të veçantë publikë të Kosovës për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit.

Kryetarja – në fillim bëri një përmbledhje të përmbajtjes dhe të rëndësisë me interes të veçantë të Propozim-Vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trases zonë me interes të veçantë publik të Kosovës për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdar dhe Prishtinë-Hani i Elezit. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se për seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, parashihet të jetë në rend dite shqyrtimi i këtij Propozim vendimi të Qeverisë.

Kryetarja, fjalën ia dha përfaqësuesit të ZKM-së, Fehmi Stubllës i cili foli për rëndësinë e Projekt-Vendimit dhe i ftojë Komisionin që ta miratojë.

Në vazhdim fjalën ia dha Adem Grabovcit -zv.Ministër i MTT-së, e që në pika të shkurtra e arsyevoj propozim vendimin, për të shpallur si zonë me interes të veçantë publike të Kosovës, trasenë nëpër të cilën do të ndërtohet autoudha Morinë-Merdare dhe Prishtinë-Hani i Elezit, po ashtu duke shpjeguar se janë bërë të gjitha studimet për të filluar më punë vetëm po presim andaj kërkojmë mbështetjen e Kuvendit për këtë çështje.

Berim Ramosaj – duke e vlerësuar projektin mjaft madhor dhe të rëndësishëm parashitroi pyetjen se ka apo jo bazë juridike për shpronësim, dhe në përgjigjen e përfaqësuesit të ZKM-së, se edhe pse Ligji për shpronësim ende nuk është shpallur nga PSSP-ja, shpronësimi mund të behet në bazë të Ligjit ende në fuqi për eksproprijim. Ramosaj kërkoi sqarime për arsyen e nxjerrjes së Vendimit për shpallje të zonës me interes të veçantë, derisa ekziston ligji për shpronësim.

Safete Hadergjonaj – po ashtu e përkrahu Propozim Vendimin e Qeverisë, për të shpallur si zonë me interes të veçantë, trasenë për ndërtimin e autoudhës, duke i ftuar edhe të tjerët që ta mbështesin.

Kryetarja – në vazhdim e mbështetur edhe nga anëtarët tjerë kërkoj një shpjegim juridik lidhur më këtë çështje.

Hasan Tahiri (nga zyra mbështetëse e Komisionit) - tha se shpallja e trasesë zonë me interes të veçantë, nëpër të cilën do të kalojë autostrada i paraprinë procedurës, për mundësinë e fillimit të procedurës së shpronësimit të titullarëve të pronave private dhe shoqërore, duke theksuar se prona shoqërore për momentin është sferë e rezervuar e UNMIK-ut.

Fatmir Rexhepi – në shenjë mospajtimi në lidhje më procesin e mbarëvajtjes së mbledhjes së Komisionit (ngase përfaqësuesi i ZKM-së, filloi të përshkruaj diskutimin e vetë drejtpërdrejtë zv. ministrit z.Grabovci), si dhe në mungesë të kohës (kishte takim tjetër) e lëshoi mbledhjen.

Múfera Şinik – theksoj së është dakord që të nxirret një rekomandim nga Komisioni për të mbështetur propozim vendimin e Qeverisë.

Bazuar në përmbajtjen e diskutimeve, Kryetarja propozoi rekomandimet në vijim:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës;

- që të miratojë Projekt-Vendimin e Qeverisë për shpalljen e hapësirës – trasesë, zonë me interes të veçantë publik në Kosovë, për ndërtimin e Autoudhes Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit;

- që të ndërmer veprime procedurale në Zyrën e PSSP-së, për shpalljen e Ligjit për shpronësim nr. 02/L-97 të miratuar në Kuvendin e Kosovës më 08.02.2007 dhe,

- t'i rekomandohet Qeverisë që të formojë një Komision të pavarur profesional (që do t'i raportoj Kuvendit të Kosovës) për mbikëqyrjen e ligjshmërisë për shpronësimin e zonës nëpër të cilën do't ndërtohet Autoudha Morinë- Merdarë dhe Prishtinë- Hani i Elezit;

Anëtarët e Komisionit u pajtuan një zëri me këto rekomandime.

III – Të ndryshme;

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit që deputetja Sala Berisha – Shala, ka proceduar disa amendamente, në lidhje më Projektligjin për Plotësim Ndryshim të ligjit për mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Safete Hadergjonaj – duke folur si kryesuese e grupit punues të Projektligjit për Plotësim Ndryshim të Ligjit për mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, tha se duhet të organizohet një mbledhje e veçantë dhe të shqyrtohen si amendamentet e propozuara, ashtu edhe raporti i Komisionit i përcjellur për Komisionin e buxhetit sepse janë shtuar dhe ndryshuar disa amendamente të cilat Komisioni nuk i ka miratua.

Pas diskutimit, anëtarët e Komisionit u pajtuan dhe nxorën:

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen amendamentet e propozuara nga deputetja Sala Berisha –Shala, lidhur me Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

Mbledhja përfundoi në orën 13:15;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani